Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur" "Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore Blloku që kufizohet nga rruga "Demi Nazeri" – "Princ Vidi" – "Gjok Doci"

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **“Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore Blloku që kufizohet nga rruga “Demi Nazeri” – “Princ Vidi” – “Gjok Doci”.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-05754-01-30-2019

Fondi limit: 166,074,378.01 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë pikë zero një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontratës: 13 (trembëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.03.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 5 datë 04.02.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha & “A.L-Asfalt” shpk**
NUIS K01730502W & NUIS K81511508A

Vlera e ofertës = **124,430,810** (njëqind e njëzetë e katër milion e katërqind e tridhjetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

- 2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk**
NUIS K02727202O & NUIS L26310801C

Vlera e ofertës = **135,836,446.29** (njëqind e tridhjetë e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzetë e gjashtë pikë njëzetë e nëntë) lekë pa TVSH.

- 3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk**
NUIS K21622001M & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **137,298,480** (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Senka” shpk**
NUIS K51712017A & NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = **137,805,460** (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb-Shpresa” shpk & “Egland” shpk**
NUIS K62320011G & NUIS J72110003F & NUIS J96829419D

Vlera e ofertës = **140,000,000** (njëqind e dyzetë milion) lekë pa TVSH.

- 6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kola Invest” shpk & “Euroteorema Peqin” shpk**
NUIS K93103401G & NUIS J61905050M

Vlera e ofertës = **140,871,401** (njëqind e dyzetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e një) lekë pa TVSH.

- 7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Varaku-E” shpk**
NUIS K51501008J & NUIS J61902509S

Vlera e ofertës = **144,444,444** (njëqind e dyzetë e katër milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

- 8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk**
NUIS L42215009L & NUIS J68007522L

Vlera e ofertës = **147,357,140.89** (njëqind e dyzetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzetë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

- 9. Operatori ekonomik “Gjikuria” shpk**

NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = **149,293,090** (njëqind e dyzetë e nëntë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 10. Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk**

NUIS J64324443V

Vlera e ofertës = **159,437,745.46** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetë e pesë pikë dyzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- 1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha & “A.L-Asfalt” shpk**

NUIS K01730502W & NUIS K81511508A

- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a për të provuar përvoje të sukseshme punë ka paraqitur dy kontrata me objekt si më poshtë:
 - **“Ndërtim Rruga “Liria” vazhdim”** me vlerë **77,997,255** (shtatëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, I cili nuk plotëson piken 1, germa “a” të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit, ku kërkohet që Operoret Ekonomik duhet të paraqesin: *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: : 83,037,189 (tetëdhjetë e tre milion e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit”*.
 - **“Banesë Individuale 2 Kat”** me vlerë **6,250,642** (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, e cila nuk përkon me objektin që po prokurohet dhe vlera e kontratës nuk është 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: : **83,037,189 (tetëdhjetë e tre milion e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit”**, cka bie në kundërshtim me Kapacitetin Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit me pikën “Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.
- Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk nuk ka paraqitur List pagesën e muajit dhjetor 2018, sic është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa “b” ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqese List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Janar 2018 - Janar 2019** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”*.
- Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk nuk ka paraqitur numrin e punonjësve për muajin Janar 2019, sic është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa “a” ku ndër të tjera parashikohet se: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqese Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhen Janar 2018 - Janar 2019”*.
- Nga dokumementacioni i paraqitur për stafin teknik, rezulton se Inxhinieri Ndërtimit (profili transport) me iniciale J.M, nuk figuron në listpagesat e shoqërisë “Liqeni VII” sh.a për 6 (gjashtë) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5 ku përcaktohet se: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, libeze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:*
 - *1(një) inxhinier Ndërtimi*
 - ***1(një) inxhinier Ndërtimi (profili transport)***
 - *1(një) inxhinier Elektrik*
 - *1(një) inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshaidet/Gjeomatik*
 - *1(një) inxhinier Hidroteknik*

- *1(një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)”.*
- Operatori ekonomik “A.L-Asfalt” shpk nuk plotëson pikën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit , Kapaciteti Teknik *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1(një) mjek të përgjithshëm”. (Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm). Operatori ekonomik “A.L-Asfalt” shpk ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me subjektin “S.SH.P STUDIO” mbi sigurimin e funksionimit e shërbimit mbi çeshtjet shendetësore në punë dhe në ndërrmarrje, cka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit me pikën 6, pasi nuk janë pjesë e stafit të shoqërisë dhe nuk figurojnë në listpagesa.*
- Mjeti Autobitumatriçe, me targë AA 365 IB i deklaruar nga operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Dhimitër Shuteriqi”, për të cilën ky Operator është shpallur fitues.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sh.a & “A.L-Asfalt” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamiona përkatësisht me targa KR 7924 A si dhe AA684NH. Pasi verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se kamioni me targë KR 7924 A ka kapacitet mbajtës 24.8 ton, ndërsa mjeti me targë AA 684 NH ka kapacitet mbajtës 24.3 Ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha & “A.L-Asfalt” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamion me kapacitet mbajtës 15 – 20 ton”***.
- Operatori Ekonomik “A.L-Asfalt” shpk ka paraqitur *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”*, me objekt tjetër prokurimi, datë zhvillimi jo të saktë, si dhe fond limit jo të kësaj procedure, çka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: ***“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme, e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”***.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha & “A.L-Asfalt” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk

NUIS K027272020 & NUIS L26310801C

- Deklarata mbi Disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, e konkretisht nga Shoqëria “Meteo” shpk, nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar, pasi brenda një deklaratë janë të dhenat e dy subjekteve të ndryshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “d”.

- Shoqëria “Bajrami N.” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 5 (pesë) punonjës murator. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur u konsatua kontrata e punës e paraqitur për punonjës të iniciale E. S është fotokopje, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk ka deklaruar 3 (tre) punonjës hidraulik. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur u konsatua kontrata e punës e paraqitur për punonjës të iniciale A. Sh dhe K. Sh janë fotokopje, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatua se është paraqitur vetëm me Deklaratë Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa a), ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jepen aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.”*
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamionçina përkatësisht me targa AA 115 KZ dhe AA 961 FP. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e tyre, u konstatua se për mjetin me targa AA 961 FP nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa “a”.
- Për mjetin Autobotmatricë me targa AA 180 MB nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa “b”.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot Uji. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se mjeti rezultoi të jetë Autobot Uji i montuar = Kamionçinë + Depozitë Uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot Uji”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, germa “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk

NUIS K21622001M & NUIS K71412003A

- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Janar 2018 - Janar 2019 të vërtetuar me...”, pasi referuar Akt-Marrëveshjes për Bashkepunim të Përkohshëm Nr. 726.Rep, Nr. 203.Kol, datë 01.03.2019, ky Operator duhet të ketë në dispozicion për kontratën objekt prokurimi 51 (pesëdhjetë e një) punonjës por referuar kontratave të nënshkruara midis operatorit ekonomik dhe Bashkisë Tiranë me objekt: 1. “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”; 2. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza I”; 3. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”; 4. “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”, të cilat nuk i kanë përfunduar efektet tekniko-financiare, si dhe referuar diferencës midis numrit të punonjesve të anagazhuar në keto kontrata dhe punësimit mesatar të operatorit ekonomik rezulton **një numër i pamjaftueshëm punonjësish**.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Kamion me kapacitet mbajtës 15 Ton deri 20 Ton/ 2 copë” pasi për dy kamionët e deklaruar në Shtojcën 10, respektivisht me targë AA 983 HX dhe AA 984 HX nuk është paraqitur **Certifikata e Pronësisë** cka bie në kundërshtim edhe me përcaktimin e gërmës “a” të kësaj pike: “ Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)..... ”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Kamion me kapacitet mbajtës 10 Ton deri 15 Ton /4 copë” pasi kamioni me targë AA 312 NF i deklaruar në Shtojcën 10 si kamion me kapacitet mbajtës 10-15 ton, nga verifikimi i dokumentacioni rezulton të jetë **mbi kapacitetin e kërkuar**, me një tonazh 15,5 ton.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)” pasi mjeti Autobitumatrice me targë AA 257 MM i deklaruar nga Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk rezulton **pa Certifikatë për Transport Mallrash të Rrezikshme** ndërsa mjeti Autobitumatrice me targë AA782FA i deklaruar nga operatori ekonomik “BE-IS” shpk rezulton **i angazhuar** në kontratën e nënshkruar me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”.

- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 Ton /3 copë”, pasi për kamioncinën me targë AA 650 TH, **Certifikata e Kontrollit Teknik rezulton e pavlefshme**, e vlefshme deri në datë 02.03.2019 dhe kamioncina me targë KR 5570 A rezulton **pa Certifikatën e Pronësisë** cka bie në kundërshtim edhe me përcaktimin e gërmës “a” të kësaj pike: “ Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)..... ”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autobot uji/1 copë” pasi mjete Autobot Uji me targë AA 176 NH i deklaruar në Shtojcën 10 nga operatori ekonomik “BE-IS” shpk **rezulton i angazhuar** në kontratën e nënshkruar me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autovinc/1 copë” pasi mjete Autovinc me targë AA356SF i deklaruar në Shtojcën 10 nga operatori ekonomik “BE-IS” shpk **rezulton i angazhuar** në kontratën e nënshkruar me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Senka” shpk

NUIS K51712017A & NUIS J94808405Q

- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafit teknik, u konstatua se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga shoqëria “Kacdedja” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafit teknik, u konstatua se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga shoqëria “Senka” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk dhe “Senka” shpk nuk janë të pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.

- Për mjetin Autobitumatriçe përkatësisht me targa AA 479 EU nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10, shoqëria “Kacdedja” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionçina përkatësisht me targa TR 0344 L dhe AA 562 DO. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se nuk është paraqitur “Çertifikata për transport mallrash brenda vendit”. Për sa më lart, shoqëria “Kacdedja” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjeti (akti i pronësisët):b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk dhe “Senka” shpk ka deklaruar se disponon 6 (gjashtë) Kamiona përkatësisht me targa AA 421 NX; AA 226 NJ; AA 585 NE; AA 114 GU; TR 5106 R si dhe AA 263 FK. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se kamioni me targë AA 421 NX ka kapacitet mbajtës 25.6 Ton, kamioni me targë AA 226 NJ ka kapacitet mbajtës 20.8 Ton, kamioni me targë AA 585 NE ka kapacitet mbajtës 25.1 Ton, kamioni me targë AA 114 GU ka kapacitet mbajtës 25.2 Ton, kamioni me targë TR 5106 R ka kapacitet mbajtës 19.4 Ton, ndërsa mjeti me targë AA 263 FK ka kapacitet mbajtës 25 Ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamion me kapacitet mbajtës 15 – 20 ton”**.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk dhe “Senka” shpk ka deklaruar se disponon 6 (gjashtë) Kamiona përkatësisht me targa AA 421 NX; AA 226 NJ; AA 585 NE; AA 114 GU; TR 5106 R si dhe AA 263 FK. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se kamioni me targë AA 421 NX ka kapacitet mbajtës 25.6 Ton, kamioni me targë AA 226 NJ ka kapacitet mbajtës 20.8 Ton, kamioni me targë AA 585 NE ka kapacitet mbajtës 25.1 Ton, kamioni me targë AA 114 GU ka kapacitet mbajtës 25.2 Ton, kamioni me targë TR 5106 R ka kapacitet mbajtës 19.4 Ton, ndërsa mjeti me targë AA 263 FK ka kapacitet mbajtës 25 Ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Operatori ekonomik duhet të disponojë 4 (katër) kamion me kapacitet mbajtës 10 – 15 ton”**.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Senka” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kola Invest” shpk & “Euroteorema Peqin” shpk

NUIS K93103401G & NUIS J61905050M

- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamionçina përkatësisht me targa TR 9575 S dhe AA 781 CG. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për disponimin e mjeteve të sipërcituara, rezulton se kamionçinat e sipërcituara kanë kapacitet mbajtës 3.4 Ton secila, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton”*.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Fadromë”, të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa a), ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.”*
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, germa “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kola Invest” shpk & “Euroteorema Peqin” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Varaku-E” shpk

NUIS K51501008J & NUIS J61902509S

- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për vërtetimin e përvojës së suksesshme rezulton se asnjë nga anëtarët e Bashkimit nuk përmbush punët e ngjashme pika “a” dhe pika “b”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Varaku-E” shpk ka deklaruar se kanë në bashkëpunim 5 punonjës murator. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për punonjësit e sipërcituar, rezulton se për muratorët me iniciale N.N; A.SH dhe K.D nuk janë paraqitur dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka paraqitur Deklaratën 10 për objektin: “Rikonstruksion rruga (Babrru Qendër + Shpat) kufizuar nga rrugët Sali Murati fillimi + Spiro Kote + Pjetër Budi + Lidhëse Prengaj + Sulejman Vokshi + Vazhdimi i Zef Serembe”, çka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: ***“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme, e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”***.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe me targa AA 548 NX. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 794 CP, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 3 (tre) Autobetoniere”***.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Elektrosaldatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku ndër të tjera përcaktohet se: ***“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Elektrosaldatriçe”***.
- Gjithashtu referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Vibrator betoni, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku ndër të tjera përcaktohet se: ***“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Vibrator betoni”***.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 4 (katër) kamiona përkatësisht me targa AA 735 PY ; DV 3043 A; AA 241 UF si dhe AA 182 UF. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për disponimin e mjeteve të sipërcituara, rezulton se kamioni me targa AA 735 PY ka kapacitet mbajtës 11.9 Ton; kamioni me targa DV 3043 A ka kapacitet mbajtës 10.6 Ton; mjeti me targa AA 241 UF ka kapacitet mbajtës 19.8 Ton ndërsa mjeti me targa AA 182 UF ka kapacitet mbajtës 13.3 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamiona me kapacitet mbajtës 15 – 20 Ton”***.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 5 (pesë) kamionçina përkatësisht me targa AA 698 MZ ; AA 961 BV; AA 907 DD; TR 3893 F si dhe AA 392 CU. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për disponimin e mjeteve të sipërcituara, rezulton se kamionçina me targa AA 698 MZ ka kapacitet mbajtës 3.1 Ton; për kamionçinën me targa AA 961 BV nuk është paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e mjetit; mjeti me targa AA 907 DD ka kapacitet mbajtës 3.5 Ton, por nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit; kamionçina me targa TR 3893 F ka kapacitet mbajtës 4.6 Ton, por nuk është paraqitur Akti i Pronësisë; ndërsa mjeti me targa AA 392 CU ka kapacitet mbajtës 4.6 Ton, por nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Varaku-E” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

7. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk

NUIS L42215009L & NUIS J68007522L

- Shoqëria “Junik” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar” pasi pasqyrat financiare/bilancet për vitet 2015, 2016, 2017 rezultojnë të pakonfirmuara nga Dega e Tatim Taksave.
- Shoqëria “Junik” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën..... Punë të ngjashme për një objekt të vetëm.....” pasi për përmbushjen e kësaj kërkesë është paraqitur kontrata me objekt: “Ndërtim dhe Rikonstruksion i Repartit Renea (Loti I-rë Sistemit e jashtme), pra një objekt jo i ngjashëm me objektin e prokurimit (rikonstruksion i infrastrukturës rrugore).
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk nuk plotëson germën “b” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)” pasi mjeti Autobitumatrice me targë AA 032 UB i deklaruar nga operatori ekonomik “Pepa Group” shpk rezulton **pa Certifikatë për Transport Mallrash të Rrezikshme**.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autobot uji/1 copë” pasi mjeti Autobot Uji me targë AA 635 NE i deklaruar në Shtojcën 10 nga operatori ekonomik “Pepa Group” shpk **rezulton mjet i montuar**, kamion i certifikuar për transport mallrash për llogari të vet.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

8. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

NUIS J62903456H

- Në Vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore, Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk nuk ka të specifikuar numrin e punonjësve për muajin Janar 2019, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, gërma “a”.
- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, u konstatua se Shoqëria “Gjiguria” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për Inxhinierin Hidroteknik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk ka deklaruar se disponon 4 (katër) Kamiona përkatësisht me targa AA 048 1V; AA 204 LA; AA 496 LA si dhe AA 187 LK. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se kamioni me targë AA 048 1V ka kapacitet mbajtës 16 Ton, kamioni me targë AA 204 LA ka kapacitet mbajtës 16.2 Ton, kamioni me targë AA 496 LA ka kapacitet mbajtës 16.5 Ton, ndërsa mjete me targë AA 187 LK ka kapacitet mbajtës 14 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 4 (katër) kamion me kapacitet mbajtës 10 – 15 ton”*.
- Shoqëria “Gjiguria” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm për mjetin e deklaruar Autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

9. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk

NUIS J64324443V

- Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk ka deklaruar si Drejtues Teknik Z. G.D, i cili pas verifikimeve rezulton se është i angazhuar si drejtues teknik në objektin: “Rehabilitimi i aksit mbikalim Kombinat”, për të cilin Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me Nr. 1189/3 Prot. datë 13.03.2018 me Bashkinë Tiranë, punime të cilat ende vazhdojnë. Për sa më lart Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3.
- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, u konstatua se Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Shoqëria “G.P.G Company” shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.

- Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk nuk është i pajisur me licencë profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.
Referuar Shtojcës 10, mjetet: Kamionçinë me targa AA 854 OJ ; Autovinç me targa AA 685 DN ; Autobot Uji me targa AA 793 RN si dhe Autobitumatriçe me targa AA 354 DG janë deklaruar në procedurën me objekt: “Rehabilitimi i aksit mbikalim Kombinat” për të cilën Operatori ekonomik ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë. Për sa më lart, Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “f”.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatua se është paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, germa a), ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.”*
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Mela.” shpk & “Alb-Shpresa” shpk & “Egland” shpk**, me adresë: **Rruga “Maliq Muço”, Ndërtesa 6, Hyrja 4, Ap. 14, Njësia Bashkiake 9, Kodi Postar 1016, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **140,000,000** (njëqind e dyzetë milion) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 25.03.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të

Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur një ankesë nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Varaku E” shpk të cilës ju kthye përgjigje nga KSHA nëpërmjet shkresës Nr. 14107/2, datë 04.04.2019, ndërsa gjatë pritjes së afatit për ankesa pra Komisionit të Prokurimit Publik nuk u paraqit asnjë ankesë.

BASHKIA E TIRANËS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr:“Ibrahim Rugova”, pranë gardës së Republikës, Pallati “Kontakt”, mbi Union Bank, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Fabrika e Qelqit”, “Konferenca e Pezës”. “Besim Alla” dhe “Jorgo Panajoti” – Faza I”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Fabrika e Qelqit”, “Konferenca e Pezës”. “Besim Alla” dhe “Jorgo Panajoti” – Faza I”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-05549-01-29-2019.

Fondi limit: 208,333,333.34 (dyqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 129, datë 15.11.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”, (i ndryshuar), rialokuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 18.03.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet) Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 5 datë 04.02.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk

NUIS K020030010

Vlera e ofertës = **153,373,696.94** (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Kthella” shpk

NUIS J69303023D

Vlera e ofertës = **160,548,286** (njëqind e gjashtëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk

NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = **169,909,814.50** (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntë mijë e tetëqind e katërmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Liqeni VII” sha & “Al-Asfalt” shpk

NUIS K01730502W & NUIS K81511508A

Vlera e ofertës = **170,354,002** (njëqind e shtatëdhjetë milion e treqind e peëdhjetë e katër mijë e dy) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bajrami N” shpk & “Meteo” shpk

NUIS K02727202O & NUIS L26310801C

Vlera e ofertës = **175,751,259.40** (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijëe dyqind e pesëdhjetë e nëntë pikë dyzetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Agi Kons” shpk & “BE-IS” shpk

NUIS K21622001M & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **177,402,693** (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e katërqind e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Everest” shpk & “Alko Impex general Construction” dshh & “RSM Company” dshh

NUIS J78311921L & NUIS K91326028I & NUIS L04803001U

Vlera e ofertës = **179,062,586** (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetëe dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS J68310708M

Vlera e ofertës = **182,789,193.80** (njëqind e tetëdhjetë e dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lala” shpk & “Vllaznia Ndërtimi IS” & “Shansi Invest” shpk & “Eral Construction” shpk

NUIS J76418903B&NUISK77524909Q&NUISJ61924002T& NUIS K82230002K

Vlera e ofertës = **187,294,056.24** (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë katër mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e katër) lekë pa TVSH

10. Operatori ekonomik “4-AM” shpk

NUIS K92005016L

Vlera e ofertës = **193,012,472.37** (njëqind e nëntëdhjetë etre milion e dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë edy pikë tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pepa Group” shpk & “Junik” shpk

NUIS L42215009L& NUIS J68007522L

Vlera e ofertës = **201,888,838.54** (dyqind e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:****1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk**

NUIS K020030010

- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk ka një punësim mesatar 64 persona për periudhën **Janar 2018 - Janar 2019**, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, ku përcaktohet se Operoret Ekonomik duhet të kenë: *“Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Janar 2018 - Janar 2019”*.
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, cka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetet të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatuas se asnjeri nga Kamionat e deklaruar nuk ka kapacitetin e kërkuar, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës (10-15 ton)”*.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Fadrome nga 2 (dy) të kërkuar, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Fadrome me goma”*.

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk ka deklaruar se disponon mjetin “Autopompe Betoni” e si rrjedhojë nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në sistemin elektronik.
- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobot uji me targë AA 418 UC rezulton të jetë i montuar = Kamion + depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18 ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji*”.
